

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Metodologjia e auditimit I

M6

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 06.10.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
Problemi 1	20	
Problemi 2	20	
Problemi 3	20	
Problemi 4	20	
Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

- a) Parimet Themelore të INTOSAI-t nuk e përkufizon auditimin e pasqyrave financiare. Sipas SNISA 100 fushëveprimi i plotë i auditimit të qeverisë përfshin auditime të rregullsisë dhe të performancës. Fushëveprimi i një auditimi të rregullsisë, i kryer sipas SNISA 100, është më i gjerë se fushëveprimi i një auditimi të pasqyrave financiare, i kryer sipas SNA-ve.

Kërkohet:

Numëroni pesë çështje që përfshin auditimi i rregullsisë. **(5 pikë)**

- b) Auditorët e sektorit publik rishikojnë gjykimet dhe vendimet e marra nga menaxhmenti në bërjen e vlerësimeve kontabël për të identifikuar ndonjë paragjykim të mundshëm të menaxhmentit të një organizate.

Kërkohet:

Cilat janë arsyet e mundshme për paragjykim nga menaxhmenti në bërjen e vlerësimeve kontabël në një entitet të sektorit publik? **(5 pikë)**

- c) ISSAI 1610 thekson se ndërkohë që auditorët e sektorit publik vendosin nëse puna e auditorëve të brendshëm ka gjasa të jetë objektive për qëllimin e auditimit, sic theksohet në paragrafin 9(a) të ISA, ata marrin në konsideratë udhëzimet e INTOSAI-t lidhur me vlerësimin e objektivitetit të auditorëve të brendshëm si dhe, nëse është relevante, ekzistencën apo raportet e çdo organi mbikëqyrës të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Kërkohet:

Shpjegoni kriteret që duhet të plotësohen që një auditim i brendshëm i themeluar përmes legjislacionit të jetë objektiv (i pavarur). **(10 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit - 1

a) Auditimi i rregullsisë përfshin:

1. Verifikimin e llogaridhënies financiare të entiteteve llogaridhënëse, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare dhe dhënien e opinioneve mbi pasqyrat financiare;
2. Verifikimin e llogaridhënies financiare të administratës qeveritare si e tërë;
3. Auditimin e transaksioneve dhe sistemeve financiare, përfshirë vlerësimin e pajtueshmërisë me statutet dhe rregulloret e zbatueshme;
4. Auditimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm;
5. Auditimin e ndershmërisë dhe përshtatshmërisë së vendimeve administrative të marra në entitetin e audituar;
6. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga auditimi, ose lidhen me të, për të cilat Institucionet Supreme të Auditimit mendojnë se duhet të shpalosen.

b) Arsyet për paragjykimet në vlerësimet kontabël në një entitet të sektorit publik

- Motivet e forta politike;
- Mjedisi politik që ndryshon ose i paqëndrueshëm;
- Pritshmëritë e rritura të publikut;
- Pritshmëritë më të larta se zakonisht për të përmbushur buxhetin;
- Reduktimi i buxheteve pa reduktimin që korrespondon me pritshmerinë nga shërbimi i ofruar;
- Partneritetet Publiko-Private;
- Toleranca e gabimeve në informacionin financiar.

c) Indikatorit kryesor që tregon se auditimi i brendshëm presupozohet të jetë objektiv është kur auditimi i brendshëm themelohet përmes legjislacionit ose rregullore dhe plotëson kriteret e mëposhtme:

- Është përgjegjës para menaxhmentit të lartë, p.sh udhëheqësit ose zv. udhëheqësit të entitetit, dhe atyre që janë të ngarkuar me qeverisje;
- Raporton rezultatet e auditit edhe tek menaxhmenti i lartë dhe tek ata që meren me qeverisjen;
- Për nga ana organizative, ndodhet jashtë stafit dhe menaxhmentit të njësisë që po auditohet;
- Nuk ndikohet nga presioni politik gjatë auditimit dhe duhet të raportojë gjetjet, opinionet dhe konkluzionet në mënyrë objektive pa frikën e presionit politik;
- Nuk lejon stafin e të auditimit të brendshëm të auditoj veprimet për të cilat kanë qenë përgjegjës më parë, për të shmangur ndonjë konflikt të mundshëm interesi; dhe
- Ka kontakte personat që janë të ngarkuar me qeverisje.

Problemi 2

(a) Shpjegoni çka kuptohet me 'qeverisje e korporatës' dhe pse është e rëndësishme qeverisja e korporatës. **(5 pikë)**

(b) Sirena tregton që 20 vite dhe është listuar në bursë para pesë viteve. Kjo kompani ofron trajnime të specializuara në kontabilitet dhe financa.

Rregullat e bursës kërkojnë pajtueshmëri me parimet e qeverisjes së korporatës dhe drejtorët kanë besim se janë duke i ndjekur praktikat më të mira lidhur me këtë. Mirëpo, tash vonë kanë pranuar një email nga njëri nga aksionarët e mëdhenjë të kompanisë, i cili është i brengosur se Sirena nuk është në pajtueshmëri me parimet e qeverisjes së korporatës.

Bordi i Sirena përbëhet nga gjashtë drejtorë; janë katër drejtor ekzekutiv të cilët edhe e kanë themeluar kompaninë dhe dy drejtorë joekzekutiv të cilët iu bashkuan kompanisë mu para listimit në bursë. Secili drejtor ka nga një fushë specifike të përgjegjësisë dhe vetëm drejtori financiar rishikon pasqyrat financiare dhe buxhetet.

Kryeshefi ekzekutiv, Art Thana, ka themeluar komitetin e auditimit dhe është edhe anëtar i këtij komiteti së bashku me drejtorin financiar dhe një drejtor joekzekutiv. Pasi që bordi është relativisht i vogël, dhe për të kursyer, Arti së voni ka marr edhe rolin e kryesuesit të bordit. Drejtori financiar dhe kryesuesi i bordit janë personat që marrin vendime për politikat e kompenzimit dhe për auditorin e jashtëm. Po ashtu, përsëri për të kursyer, nuk është themeluar funksioni i auditimit të brendshëm për të monitoruar kontrollet e brendshme të kompanisë.

Kompenzimi i drejtorëve ekzekutiv propozohet nga drejtori financiar dhe aprovohet nga kryesuesi. Ata paguhet me paga vjetore dhe me bonuse që lidhen me të hyrat e kompanisë. Që nga listimi në bursë, drejtorët nuk janë ndryshuar dhe asnjëri nuk i është nënshtruar rizgjedhjes nga aksionarët.

Kërkohet:

Përshkruani GJASHTË dobësi në qeverisjen e korporatës me të cilat ballafaqohet Sirena dhe ofroni rekomandime për të përmirësuar këto dobësi, në mënyrë që të sigurohet pajtueshmëri me parimet e qeverisjes së korporatës. **(15 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit - 2

(a)

Qeverisja e korporatës është system sipas të cilit drejtohet ose kontrollohet një kompani. Sipas kodit të qeverisjes së korporatës së Mbretërisë së Bashkuar, 'qëllimi i qeverisjes së korporatës është të lehtësojë menaxhim efektiv dhe të matur që mundëson sukses afatgjatë të kompanisë.'

Qeverisja e korporatës konsideron përgjegjësitë e drejtorëve, se si bordi i drejtorëve duhet të udhëhiqet dhe strukturohet, nevojën për kontrole të mira të brendshme dhe marrëdhënien me auditorët e jashtëm.

Është e rëndësishme që kompanitë të konsiderojnë parime të mira të qeverisjes së korporatës për të siguruar që është menaxhmenti ose personat e ngarkuar me qeverisjen ata që udhëheqin kompaninë, ndërsa aksionarët janë pronarë dhe nuk janë të përfshirë në udhëheqjen e përditshme të biznesit.

Aksionarët duhet të sigurohen që nevojat e tyre merren parasysh nga menaxhmenti dhe se ka një process për të informuar se operohet biznesi.

(b)

Dobësitë	Rekomandimet
Kryesuesi i Sirena, është edhe kryesues dhe drejtor ekzekutiv. Duhet të ketë një ndarje të qartë të përgjegjësiave në kokë të kompanisë dhe asnjë individ nuk mund të ketë nivel të pakufizuar të vendimmarrjes pasi që kjo mund të çoj në abuzimin e fuqisë.	Rolet e kryesuesit dhe drejtori ekzekutiv duhet të ndahen dhe të mos kryhen nga personi i njëjtë. Njëri nga drejtorët joekzekutiv duhet të caktohet si kryesues. Parimet e qeverisjes së korporatës rekomandojnë që kryesuesi të jetë një drejtor joekzekutiv.
Bordi përbëhet nga katë drejtor ekzekutiv dhe dy joekzekutiv. Duhet të ketë një balans të përshtatshme të drejtorëve ekzekutiv dhe joekzekutiv për të siguruar që bordi merr vendime të duhura e që janë në interesin më të mirë të aksionarëve të kompanisë dhe jo që një individ ose grup individësh të dominojnë vendimmarrjen e bordit.	Së paku gjysma e bordit duhet të përbëhet nga drejtor joekzekutiv. Sirena duhet të konsiderojë rekrutimin e dy drejtorëve joekzekutiv shtesë.
Drejtori financiar është anëtar i vetëm i bordit i cili rishikon PF dhe buxhetet. Mirëpo, bordit duhet t'i prezentohet vlerësim i kuptueshëm i pozitës financiare të Sirena. Ata duhet të jenë në dijeni se implikimet financiare të çfardo vendimi të marr.	Drejtori financiar duhet të prodhoj informata financiare dhe buxhete dhe t'i prezantojë këto para komitetit të auditimit ose bordit të plotë. Kjo do të lejonte që të gjithë drejtorët të kuptojnë pozitën financiare të kompanisë dhe të marrin vendime të informuara.
Komiteti i auditimit përbëhet nga dy drejtorë joekzekutiv, kryesuesi dhe drejtori financiar. Komiteti i auditimit duhet të përbëhet nga joekzekutiv të pavarur dhe të mos ketë drejtorë ekzekutiv. Kryesuesi mund të jetë pjesë e komitetit të auditimit	Komiteti i auditimit duhet të përbëhet vetëm nga drejtorë joekzekutiv. Kryesuesi dhe drejtori financiar duhet të japin dorëheqje nga ky komitet. Nëse Sirena cakton drejtorë tjerë joekzekutiv, ata duhet

për kompani të ogla me kushtin nëse është drejtor joekzekutiv, që nuk është rasti i Sirena	të ftohen të jenë pjesë e komitetit të auditimit.
Detyra e kompenzimit dhe caktimit të auditorëve të jashtëm bëhet nga kryesuesi dhe drejtori financiar. Kjo detyrë duhet të kryhet nga komitetit i auditimit në mënyrë që të forcohet pavarësia e auditorit të jashtëm. Nëse drejtorët ekzekutiv janë përgjegjës, atëherë auditorët do të ndjejnë se duhet të japin opinion rezervë ose mund të hiqen.	Komiteti i auditimit duhet të ketë përgjegjësi primare të caktojë auditorin dhe nivelin e kompenzimit të tyre.
Në mënyrë që të zvogëlohet kosotja, Sirena nuk ka themeluar funksionin e auditimit të brendshëm. Komiteti i auditimit duhet të konsiderojë efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe auditimi i brendshëm duhet ta kryejë këtë rol. Në rastet kur nuk ka funksion të auditimit të brendshëm, komiteti i auditimit duhet të kërkojë një të tillë.	Duhet të konsiderohet themelimi i funksionit të auditimit të brendshëm. Për këtë arsye duhet të konsiderohet edhe kosto edhe benefiti pasi që nuk është e mjaftueshme të konsiderohet vetëm kursimi.
Kompenzimi i drejtorëve përcaktohet nga drejtori financiar dhe kryesuesi. Mirëpo, nuk duket të involvohet asnjë drejtor në përcaktimin e kompenzimit të tij/saj pasi që kjo mund të rezultoj me nivele të larta të pagesës.	Duhet të ketë një politikë të drejtë dhe transparente të përcaktimit të niveleve të kompenzimit. Drejtorët joekzekutiv duhet të vendosin për kompenzimin e drejtorëve joekzekutiv. DE dhe kryesuesi duhet të vendosin për kompenzimin e drejtorëve joekzekutiv.
Kompenzimi për drejtorët ekzekutiv përbëhet nga paga dhe bonueset vjetore. Mirëpo, pagesa duhet të motivojë drejtorët të fokusohen në rritjen afatgjatë të biznesit. Caqet vjetore mund të inkurajojnë strategji afatshkurta e jo strategji që rrisin pasurinë e aksionarëve.	Kompenzimi i drejtorëve ekzekutiv duhet të strukturohet për të përfshirë një pjesë të madhe që ka qëllin performancën afatgjatë të kompanisë. Ndoshta mund të ofrojnë opsione të aksioneve.
Asnjëri nga anëtarët e bordit të drejtorëve nuk i është nënshtruar rizgjedhjes nga aksionarët në pesë vitet e fundit. Aksionarët duhet të rishikojnë në baza të rregullta që përbërja e bordit të jetë e përshtatshme.	Drejtorët duhet t'i nënshtrohen rizgjedhjes nga aksionarët në interval të rregullta duke mos tejkaluar periudhën trevjeçare.

Problemi 3

(a) Identifiko dhe shpjego PEsË parimet kryesore të kodit të etikës së IFAC. **(5 pikë)**

(b) Fundi i vitit fiskal për Kompaninë Pastrimi është 31 dhjetor 2012. Ju jeni menaxher i auditimit dhe auditimi përfundimtar do të fillojë së shpejti. Dy çështjet në vijim janë paraqitur për tu shqyrtuar nga ju:

(i) Llogaritë e pagueshme tregtare dhe akrualet

Drejtori financiar i Pastrimit ju ka lajmëruar se ka ndodhur një gabim në librin e blerjes në fund të vitit. Në vend që libri të mbyllet më 31 dhjetor, aksidentalisht është mbyllur me 25 dhjetor. Të gjitha faturat e blerjeve në mes të datës 25 dhjetor dhe fundit të vitit janë postuar në librin e blerjeve të vitit të ardhshëm 2013. **(8 pikë)**

(ii) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë tregtare të arkëtueshme të Pastrimit historikisht kanë qenë të ulëta pasi që shumica e klientëve privat paguajnë në avans çdo muaj. Mirëpo, gjatë vitit një numër i kompanive janë regjistruar prandaj llogaritë e arkëtueshme tani janë materiale. Seniori i auditimit ka kryer konfirmimin e llogarive të arkëtueshme për gjendjet (saldot) e fundvitit, mirëpo ka një numër prej tyre që nuk i janë përgjigjur kërkesës për konfirmim dhe një numër i konfirmimeve kanë pasur ndryshime nga gjendja e kërkuar për konfirmim. **(7 pikë)**

Kërkohet:

Përshkruani procedurat e pavarura (thelbësore) që do ti kryenit për të përfutur evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për dy çështjet e mësipërme.

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit - 3

(a) Parimet themelore

Integriteti – të jesh i drejpërdrejt dhe i ndershëm në të gjitha marrëdhëniet biznesore dhe profesionale.

Objektiviteti – mos lejimi i anësisë, konfliktit të interes ose influencës së tepruar të të tjerëve për të anashkaluar gjykimet profesionale ose biznesore.

Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur – mbajtja e njohurisë profesionale dhe aftësisë të kërkuara për të siguruar se klienti pranon shërbime profesionale dhe të vepruarit me kujdes dhe në pajtueshmëri me standardet teknike dhe profesionale.

Konfidencialiteti – ruajtja e informatave konfidenciale të pranuar si rezultat i marrëdhënies profesionale ose biznesore, dhe mosshpalosja e këtyre informatave tek palët e treta pa një autorizim praparak, e as përdorimi i këtyre informatave për avantazh personal.

Sjellja profesionale – pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret dhe shmangia e çfarëdo veprimi që diskrediton profesionin.

(b) Procedurat thelbësore

(i) Të pagueshmet dhe akrualet

- Llogaritni ditët e llogarive të pagueshme dhe krahasoni me vitet e mëparshme, hetoni çfarëdo ndryshimi të rëndësishëm, sidomos nëse ka zvogëlim në këtë vit.
- Krahasoni totalon e LL/P dhe listën e akrualeve kundrejt vitit të mëparshëm dhe hetoni ndryshimet e rëndësishme.
- Diskutoni me menaxhmentin procesin që ata kanë ndërmarrë për të kuantifikuar nënvlerësimet e LL/P për shkak të gabimeve me prerjesn dhe konsideroni maerialitetin e gabimeve.
- Diskutoni me menaxhmentin nëse është përfshirë ndonjë korrigjim për atë nënvlerësim.
- Përzgjedhni një mostër të faturave të blerjes të pranuar në mes të periudhës 25 dhjetor dhe fundit të vitit dhe ndjekni ato deri te përfshirja në akruale ose si pjesë e korrigjimeve të LL/P.
- Rishikoni pagesat pas datës së raportimit; nëse ato kanë të bëjnë me vitin aktual, pastaj ndjekni deri te libri i blerjeve ose lista e akrualeve për të siguruar se janë regjistruar në periudhën e duhur.
- Përftoni ekstraktet e furnitorëve dhe harmonizoni ato me saldot nga libri i blerjes dhe hetoni ndonjë element.
- Përzgjedhni një mostër të saldove të LL/P dhe kryeni konfirmimin e LL/P, ndiqni çfardo mos-përgjigje nga furnitorët dhe mosbarazim në mes të konfirmimit dhe saldove të LL/P.
- Përzgjedhni një mostër të fletpranimeve të mallrave para fundit të vitit dhe pas fundit të vitit dhe ndiqni nëse janë regjistruar në periudhën e duhur.

(ii) Të arkëtueshmet

- Për mos-përgjigjet, me lejen e klientit, ekipi duhet të arranzhojë dërgesën e sërishme të konfirmimeve.
- Nëse të arkëtueshmet nuk përgjigjen as këtë herë, me lejen e klientit, seniori i auditimit duhet ti telefonojë konsumatorit dhe të pyes nëse janë në gjendje të përgjigjen në konfirmim.
- Nëse edhe më tutje nuk ka përgjigje, seniori i auditimit duhet të ndërmerr hapa alternative për të konfirmuar të arkëtueshmet.
- Për përgjigjet me diferenca, seniori duhet të identifikojë shumat e diskutueshme dhe të identifikojë nëse këto kanë të bëjnë me ndryshimet kohore ose gabime të mundshme.
- Çfarëdo ndryshimi për shkak të diferencës kohore, siç është paraja në transit, ato duhet të përputhen me pranimet e parasë pas fundit të vitit në librin e parasë.
- Libri i të arkëtueshmeve duhet të rishikohet për të identifikuar gabime në postim dhe kjo mund të jetë arsyeja pse konfirmimet e konsumatorëve kanë diferenca.
- Nëse ka pasur saldo që janë shënjuar si saldo të diskutueshme nga konsumatorët, ato duhet të diskutohen me menaxhmentin për të identifikuar nëse ka nevojë për shlyerje.

Problemi 4

Lidhur me zbulimin e mashtrimit, auditori në sektorin publik duhet të mbështetet në udhëzimet e SNA 240 Përgjegjësia e auditorit lidhur me mashtrimin në auditimin e pasqyrave financiare dhe ISSAI 1240:

Kërkohe:

- a. Si përkufizohet mashtrimi? (2 pikë)
- b. Përshkruani objektivat e auditorit lidhur me mashtrimin. (3 pikë)
- c. Përshkruani kushtet që zakonisht janë prezente kur ndodhë një mashtrim. (9 pikë)
- d. Listoni përgjigjet e auditorit në rreziqet e identifikuar të mashtrimit. (3 pikë)
- e. Listoni shembuj të transaksioneve jashtë operacioneve normale të entiteti që duhet të konsiderohen në sektorin publik gjatë vlerësimit të mashtrimit. (3 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit - 4

a. Mashtrimi – një veprim i qëllimshëm nga një ose më shumë individ në mesin e menxhmentit, personave të ngarkuar me qëverisjen, punonjësve, palëve të treat, përshtirë përdorimin e mashtrimit për të përfituar përparësi të pabarabart ose jologjor.

b. Objektivat e auditorëve janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive material në pasqyrat financiare për shkak të mashtrimit;
- Të përftoj dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me rreziqet e vlerësuara të anomalisë materiale për shkak të mashtrimit, përmes dizajnit dhe implementimit të përgjigjeve të përshtatshme; dhe
- Për tu përgjigjur/reaguar në mënyrë të përshtatshme ndaj mashtrimit ose mashtrimit të dyshuar të identifikuar gjatë auditimit.

c. Zakonisht janë tri kushte prezente kur ndodhë mashtrimi. Këto tri kushte janë zakonisht prezente në mënyra të ndryshme në sektorin publik:

- Nxitja ose presioni (e vendosur mbi ose e perceptuar nga menaxhmenti ose punonjësit që u jap arsye të bëjnë mashtrimin) – punonjësit në sektorin publik janë shpesh nën presion për të ofruar shërbime të cilësisë së lart me pak burime dhe të përmbushin pritjet buxhetore. Kjo mund të jetë veçanërisht relevante në kushte të vështira ekonomike kur ka presion të ruhen të hyrat nga tatimet dhe taksat, që rezultojnë në mbivlerësimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Po ashtu mund të jetë presion që të shpenzohet buxheti deri në fund të vitit;
- Mundësia (karakteristika ose rrethana që lidhen me entitetin që lejon të kryhet mashtrimi) – mjedis i vështirë i rekrutimit ose mungesë e personelit të kualifikuar mund të jetë factor më i shpeshtë në sektorin publik. Situata të tilla shpesh mund të rezultojnë në mangësi në kontrollet e brendshme duke krijuar kështu mundësi të ndodhjes së mashtrimit. Përdorimi i shumtë i transaksioneve më vëllim të madh me

vlerë të vogël në para të gatshme në departamentet policore ose klinikat shëndetësore mund të rrisë këtë rrezik. Edhe pse vlerat monetare mund të jenë të vogëla, situata të tilla mund të çojnë në shkeljen e besimit nga publiku, pritjes dhe llogaridhënies; dhe

- Racionalizimi ose sjella (sjellja, karakteri ose vlerat etike që i lejojnë individëve të arsyetojnë kryerjen e mashtrimit) – në përgjithësi nivelet e ulëta të pagave në sektorin publik krahasuar me sektorin privat mund të shkaktojnë që punonjësit të besojnë se mund të arsyetojnë keqpërdorimin e fondeve. Si më sipër kjo mund të çojë në shkeljen e besimit nga publiku, pritjes dhe llogaridhënies.

d. Transaksionet domethënëse që janë jasht operacioneve ose aktiviteteve normale të entitetit të audituar mund të përfshijnë:

- Nxitësit e zhvillimit ekonomik;
- Provizione të ngarkuara në kontrata të sindikatave;
- Blerjet ose shitjet e pronave të palujtshme;
- Këmbimet e tokave;
- Dhënia e të drejtave të shfrytëzimit të pasurisë;
- Partneritetet publiko-private;
- Privatizimi i shërbimeve qeveritare;
- Kthimi i hershëm i borxheve; dhe
- Garancionet ose siguria qeveritare për të shpëtuar entitetet e sektorit privat nëse kanë vështirësi financiare.

Problemi 5

a. Përshkruani PESË kërcënimet e pavarësisë sipas Kodit të Etikës së IFAC dhe për secilin kërcënim listoni nga NJË shembull ose rrethanë që mund ta krijojë atë kërcënim. **(5 pikë)**

b. Supozoni se firma juaj e auditimit ka dy klient të auditimit, Kompaninë A dhe Kompaninë B. Kompania A i është ofruar Kompanisë B lidhur me një investim të mundshëm të përbashkët. Sipas këtij propozimi, Kompania A do ta ofronte ekspertizën, përderisa Kompania B do ta ofronte financimin.

Si auditor i Kompanisë A, ju e dini se kjo kompani është duke u ballafaquar me probleme serioze financiare. Prandaj ja keni bërë vetes pyetjen nëse do të ishte e mençur për Kompaninë B të bënte një investim mjaft të madh. Nëse investimi i përbashkët do të dështonte, aksionarët e Kompanisë B do të vuanin humbje të mëdha dhe shumë nga punonjësit e saj do ta humbnin punën.

Shqetësimi juaj për aksionarët dhe punonjësit e kompanisë B ju ka shtyrë të mendoni nëse duhet të "paralajmërohet" Kompania B për këtë rrezik të investimit në propozimin e Kompanisë A. Prandaj ju keni vendosur të konsultoni Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të IFAC.

Kërkohet:

Diskutoni përgjegjësitë tuaja për secilin nga klientët e mësipërm sipas kodit të etikës. Duhet të jeni sa më specifik lidhur me veprimet që duhet të ndërmerrni në këtë situatë. **(15 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit - 5

a) Pesë kategoritë e kërcënimeve që ndikojnë në pavarësinë e auditorit janë:

- Interesi vetiak (personal)
- Vetë-rishikimi
- Avokimi
- Familiariteti (njohja)
- Frikësimi.

Shembuj të secilës kategori (kërkohet vetëm një shembull)

Interesi vetiak (personal)

- Varësi e tepruar në arifat nga një klient
- Marrëdhënie të ngushta personale ose biznesore
- Interes financiar të klienti
- Përdorim i papërshtatshëm i pasurive të korporatës

Vetë-rishikimi

- Anëtarët e ekipit të auditimit janë punësuar së voni nga klienti nga pozitë e cila ndikon çështjen që auditohet

- Përfshirja në implementimin e sistemit financiar dhe raportimi i mëvonshëm mbi operimin e atij sistemi
- Kryerja e një shërbimi pëe klientin që ndikon direkt në çështjen që auditohet.

Avokimi

- Të vepruarit si avokar i klientit në konflikte ose çështje gjyqësore
- Promovimi i aksioneve për një klient të listuar
- Komentimi në public i ngjarjeve në të ardhmen për rrethana të caktuara

Familiariteti (njohja)

- Shoqërim i gjatë me klientin
- Pranimi i dhuratave ose trajtimit preferencial (vlerë domethënëse)
- Njohje e tepruar me menaxhmentin
- Partneri i mëparshëm i firmës është punësuar nga klienti

Frikësimi

- Kërcënimi me padi gjyqësore
- Kërcënimi i largimit të firmës së auditimit
- Personalitet dominues i klientit ose ndonjë drejtor që përpiket të ndikojë vendimet e auditorit
- Presion për të zvogëluar vëllimin e punëve të auditimit për të zvogëluar tarifën e auditimit

b) Kodi i Etikë së IFAC thekson: “Parimi i konfiencialitetit imponon një obligim mbi kontabilistët profesionist që të përmbahen nga:

- (a) Shpalosja jashtë firmës ose organizatës në të cilën janë të punësuar të çfardo informate konfidenciale të pranuar si rezultat i marrëdhënies profesionale pa autorizim përveç nëse kërkohet me ligj ose nga obligimi profesional; dhe
- (b) Përdorimi i informatës konfidenciale të pranuar si rezultat i marrëdhënies profesionale për përfitim personal ose për palë të treta

Mirëpo, Kodi po ashtu në seksionin e integritetit thekson “Një kontabilist profesionist nuk me vetëdije të shoqërohet me raporte, deklarata, komunikime ose informata tjera kur kontabilisti profesionist beson se informata:

- (a) Përmban deklarata të rrejshme ose çorientuese;
- (b) Përmban deklarata ose informata të përgatitura në mënyrë të pakujdesshme; ose
- (c) Shmag ose fsheh informatën që kërkohet të përfshihet nëse mospërfshirja e saj do të çojë në informata çorientuese.

Kur kontabilisti profesionist vihet në dijeni se ai/ajo është shoqëruar me informata të tilla, kontabilisti duhet të ndër marr hapa që të përfundoj shoqërimin me këtë informatë.

Në fund, në seksionin e konfliktit të interes, Kodi thekson: “Varësisht nga rrethanat që rezultojnë me një konflikt të interes, duhet të zbatohet njëra nga masat mbrojtëse të mëposhtme:

- (a) Njoftimi i klientit lidhur me interesin biznesor të firmës ose aktivitetet të cilat mund të përfaqësojnë konflikt interesi dhe marrja e aprovimit (lejes) që të veprojnë në një rrethanë të tillë; ose

(b) Njoftimi i të gjithë palëve relevante se kontabilisti profesionist është duke vepruar për dy ose më shumë palë lidhur me një çështje ku interesat e tyre përkatëse janë në konflikt dhe marrja e aprovimit për të vepruar në atë rol; ose

(c) Njoftimi i klientit se kontabilisti profesionist nuk është duke vepruar ekskluzivisht për asnjëring nga klientët në ofrimin e shërbimeve të propozuara dhe marrja e aprovimit për të vepruar në atë rol.

Në këtë rast, auditori duhet të konsideroj ndjekjen e udhëzimit nën (b) më sipër; nëse konflikti i interesit nuk është zgjidhur, auditori duhet të konsiderojë dorëheqjen nga njëri nga angazhimet, ndoshta të klientit A.